**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA DIBËR**
**KËSHILLI BASHKIAK DIBËR**

Nr. 4435 Prot

Peshkopi, më 22.09.2022

**Lënda:** Dërgim vendimi

**Drejtuar:** Prefekti i Qarkut Diber

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për dijeni Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër **Nr.77**

**Datë: 16.09.2022**

**"Trajtimi me subvencionin e qirasë familjen e Znj. Fitore Hoxha".**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**
**Afrim Mikli**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DIBËR

Nr. 1... Mberriti 6/ 28/07/22

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**PREFEKTI I QARKUT DIBËR**

Nr.922/1.prot.

Peshkopi, më 27.09.2022

Lënda : Per vendimin nr. 77, datë 16.09.2022 të Këshillit të Bashkisë Dibër

Drejtuar : BASHKISE DIBER

PESHKOPI

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.77, date 16.09.2022 "Trajtimi me subvencionin e qerasë për familjen e znj.Fitore Hoxha", konstatova se:

Akti administrativ objekt verifikimi dhe shqyrtimi bën pjesë në kategorinë e akteve me karakter individual për pasojë nuk është në kompetencë të Prefektit të shprehet për ligjshmërinë e kësaj vendimmarrje .

Hyrja në fuqi e akteve administrative të kësaj natyre, bëhet sipas parashikimeve të tjera ligjore për hyrjen në fuqi të akteve administrative të karakterit individual nën pergjegjesine direkte administrativo- ligjore të strukturave pergjegjëse që paraqesin për miratim projekt akte të kësaj natyre.

PREFEKTI

Nexhbedin SHEHU

*Adresa : Bulevardi "Elez ISUFI" Peshkopi, Albania, Tel. 00355 218 2- 2082,Tel 00355 218 2– 2631, E-mail prefekturadiber@gmail.com*

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA DIBËR**
**KËSHILLI BASHKIAK DIBËR**

**VENDIM**

**Nr. 77 Datë 16/09/2022**

## " PËR TRAJTIMIN ME SUBVENCIONIN E QIRASË "

Mbështetur në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat "a" dhe " b", nenin 24, pika 2, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore", nenit 77, pika 10, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", vendimin nr. 574, datë 29.08.2012, të Këshillit të Ministrave " Për përcaktimin e dokumentacionit, që duhet të paraqesë familja për t'u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore", VKM nr.459, datë 3.7.2019 " Për rregullat për adminsitrimin e kërkesave të Njësive të qeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirase ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet Njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin" me propozim te Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **16.09.2022** me 18 vota pro, 0 kundër dhe 0 apstenim:

**VENDOSI:**

1. Të miratojë trajtimin me subvencionin e qirasë familjen e **Znj. Fitore Hoxha** në masën 70% nga buxheti i shtetit dhe 30% nga buxheti i bashkise , ne vleren 10000 mij/lek/muaj.
2. Kohëzgjatja e pagesës së qirasë për familjen e përcaktuara në pikën 1, do të jetë deri ne muajin shkurt 2023.
3. Zëvendësimin me përfituesen Redife Bellova për shkak të mos dorëzimit të kontratës noteriale të qerasë të apartamentit. ( sipas VKB nr. nr. 10 date 08.02.2022)
4. Për familjen, e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, kryerja e pageses do të kryhet pasi të dorëzohet numri i llogarisë së qiradhënësit pranë Drejtorise Ekonomike, referuar kontrates te qerase noteriale.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Ekonomike, Sektori i Administrimit të Pronave dhe Strehimit.

Adresa: | Bulevardi "Elez Isufi" Peshkopi, email: bashkiadiber@gmail.com tel:0035521822935

6. Vendimi u shpall sot me datë 16.09.2022

**Kryetar Këshilli**

**SOKOL SAVA**